



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 102  
Prishtinë, më 11.6.2024, në orën 12:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Hajdar Beqa, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Albana Bytyqi, Halil Thaqi, Visar Korencia, Yllëza Hoti.

**Munguan:** Rashit Qalaj, Bekim Arifi dhe Adem Hoxha.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Antigona Ibraj.

**Pjesëmarrësit e tjerë:** Besnik Boletini, Shkumbin Ahmetxhekaj, Albulena Mehmeti, Merdjinac Radojica, Dardan Beqiri, Fatime Lumi Qehaja dhe Gazmend Rexhepi, RTK, Shkëlqim Xhema, Naser Arllati dhe Driada Thaqi, ZKA, Medina Halili- BIRN, Valmire Abdullahu- Ekonomia online, Fjollë Haziri, KDI, Arbenita Marmullaki, RTK-radio, Bashkim Gashi dhe Shkurte Sadiku, GP- LVV, Erona Retkoceri, praktikante në Kuvend.

**Mbledhjen e kryesoi:** Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 21.5.2024;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023.
4. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 21.5.2024**

*Procesverbali u miratua pa ndryshime.*

## **3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023**

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Të nderuar të pranishëm, pika e tretë e rendit të ditës është, shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Për ta shqyrtuar këtë pikë, ne kemi ftuar Bordin e RTK-së dhe drejtorin e përgjithshëm të RTK-së. ZKA-ja ka audituar pasqyrat financiare vjetore të RTK-së, të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2023, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Andaj pa humb shumë kohë, fjalën po ja kaloj deputetit raportues z.Hajdar Beqa.

**Hajdar Beqa:** Fillimisht e falënderoj ZKA, për këtë raport, i cili përmban pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2023, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, të RTK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. ZKA-ja ka dhënë opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore të RTK-së. Çështja që ka ndikuar në opinion të kualifikuar është se RTK-ja nuk ka bërë rivlerësimin e pasurive, për të siguruar se vlera e tyre kontabël nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë pas rivlerësimit në fund. Në regjistrin kontabël figurojnë 134 pasuri joqarkulluese me kosto historike në vlerën 677,767€, që janë zhvlerësuar në tërësi dhe vlera neto e tyre në libra është zero. ZKA-ja ka audituar edhe nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar, në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Pavarësisht kësaj, ZKA-ja ka identifikuar disa çështje që kanë ndikuar në konkluzion të kualifikuar.

**1.** RTK kishte lidhur kontratë për “Shërbime teknike për festivalin e Këngës në RTK” në vlerë 90,600€, me çmim jo siç kishte njoftuar në dosje të tenderit si dhe ishte nënshkruar 43 ditë me vonesë, pas njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

**2.** RTK në tri (3) procedura të prokurimit me vlerë së bashku prej 119,376€, kishte përdorur shkurtimin e afateve kohore për pranimin e dosjeve të tenderit, të cilat ishin në kundërshtim me kërkesat e nenit 46 të Ligjit për Prokurim Publik.

3. RTK kishte lidhur kontratë për furnizime me “Kamera PTZ dhe pajisje përcjellëse” me vlerë 53,090€, edhe pse OE nuk kishte ofruar dëshmi të qartë ashtu siç ishte kërkuar në dosjen e tenderit.

4. RTK kishte dobësi në kontratën për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese me kompensim në vlerë 55,001€, duke ndryshuar kushtet dhe çmimin e kontratës. Gjetjet tjera janë: **Pronësia e pa definuar e pasurive /objekteve ku operon RTK-ja** - Në shënimet kontabël dhe raportin e regjistrimit të mjeteve themelore të fundvitit 2023 dhe në regjistrin e pasurive, nuk është prezantuar ndërtesa në të cilën operon RTK-ja. Përkundër faktit që ndërtesa e cila shfrytëzohet nga RTK-ja ligjërisht nuk është pronë e RTK-së, ajo i sjell përfitime organizatës. Objekti është dhënë në shfrytëzim nga AKP-ja, mirëpo, nuk është ofruar ndonjë dëshmi që dokumenton se prona dhe ndërtesa në fjalë është në menaxhim të AKP-së. Pra, edhe përkundër iniciativave të bordit dhe menaxhmentit të RTK-së për të adresuar këtë çështje, si dhe rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Qeverinë që në bashkëpunim me AKP-në të definojë pronësinë e objektit të ish Radiotelevizionit të Prishtinës dhe statusin e kësaj prone, kjo çështje ende ka mbetur e pazgjidhur.

Gjetja tjetër ka të bëjë me: **Procesin e rekrutimit për staf të rregullt**- Për pozitën “**Gazetar Redaktor Ueb Faqe në RTK**”- janë vërejtur: Formulari për aplikim për punë, tek pjesa e pozitës: mungojnë përshkrimet për pozitat që kandidati ka pasur tek punëdhënësit e mëparshëm. Gjithashtu për këtë rekrutim ishte shqiptuar edhe masë ndëshkimore nga Inspektorati i Punës, duke i shqiptuar dy gjoba me vlerë nga 1,000€, e në të cilën ishte njëra nga arsyet. Njëri prej kandidatëve është ftuar për pjesëmarrje në proces të rekrutimit, edhe pse data e formularit nuk i përkiste periudhës së procesit të rekrutimi. Formulari për aplikim nuk ishte plotësuar asnjëherë tek pjesa e paraparë për plotësim nga burimet njerëzore dhe komisioni përzgjedhës. Sipas çelësit të testit me shkrim për një pyetje janë vlerësuar dy përgjigje të sakta me rumbullakime, e cila vlerësohej me 10 pikë. Ndërsa, ZKA-ja ka vërejtur se në shtatë vlerësime të kandidatëve janë vlerësuar për një përgjigje të vetme të rumbullakuar në testin me shkrim me pikët maksimale.

Te pozita “**Teknik në Facebook**”, dy formularët për aplikim për punë, nuk janë nënshkruar nga kandidatët dhe të njëjtit janë të përzgjedhur për procedura të rekrutimit më tutje.

Në pozitën “**Udhëheqës në Teknologji Informativ**”, sipas çelësit të testit me shkrim pyetja numër katër ka përgjigje të saktë me rumbullakim në opsionin (d), e cila vlerësohet me 10 pikë. Pavarësisht që kandidati kishte rumbullakuar përgjigjen e saktë, ishte vlerësuar me zero pikë. Gjitha këto, kishin ndodhur për shkak që komisioni përzgjedhës nuk i ka përfillur me kujdes proceset e seleksionimit, verifikimit të dokumentacionit të aplikuesve, vlerësimit dhe përzgjedhjes.

Këto ishin gjetjet e identifikuar nga ZKA-ja. Ne sot kemi në takim Bordin e RTK-së, drejtorin dhe zyrtarët e ZKA-së që e kanë kryer këtë auditim, për të na i dhënë sqarimet edhe neve, por edhe qytetarëve, se pse kanë ndodhur këto gjëra, sepse po diskutojmë për menaxhimin e një institucioni publik. RTK-ja është pajtuar pjesërisht me gjetjet, andaj kërkoj ta kemi edhe një sqarim me pjesën e mospajtueshmërisë.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Pas përmbledhjes nga deputeti Beqa, fjalën ja kaloj kryetarit të Bordit, z.Besnik Boletini, pastaj vazhdojmë me pyetjet nga ana e anëtarëve të komisionit.

**Besnik Boletini RTK:** ZKA-ja me auditime të dy viteve të fundit, na ka ndihmuar në përmirësimin e lëshimeve dhe gjendjes së para 3 viteve. Sa i përket çështjes së pronës nga ana e jonë është e përfunduar, sepse ne e kemi marrë edhe rekomandimin e juaj dhe ju kemi drejtua organeve përgjegjëse. Ju kemi drejtua MPB-së, ku e ka edhe administratën publike. Ka filluar një proces për objektin e radios, por procesi është ndalur. Ne i kemi ofrua gjitha gjitha dëshmitë, dokumentacionet për këtë çështje. Por, më shumë ne si RTK nuk patëm mundësi të bëjmë diçka për çështjen e pronës, prandaj në çdo auditim ka me dal pjesërisht i zbatueshëm sepse nuk varet nga ne më dhe si RTK nuk kemi fuqi të bëjmë më shumë sa i përket pronës së RTK-së.

Sa i përket gjetjeve, ne e kemi hartuar një rregullore sa i përket procesit të rekrutimeve, ku janë zgjidhë si problem këto lëshime. Por, në përgjithësi krahasuar me vitet paraprake, kemi bërë një progres shumë të madh. Ne e kemi fuqizua edhe njësinë e auditimit të brendshëm dhe e kemi rrit numrin e auditimeve, sepse rritja nga 4 auditime, sa kanë qenë në vitin 2021 dhe 13 në vitin 2024, na ndihmon sa më shumë me i përmirësua dobësitë brenda RTK-së. Po ashtu, për ta bërë një krahasim të RTK-së së vitit 2021 dhe 2013. ZKA-ja për raportin e 2021, ka thënë që PVF-të e 2021, nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, ndërsa në raportin e 2023, tashme e kemi një pamje të drejtë dhe të vërtetë. Shpejt do ta kemi edhe planin e veprimit dhe do ta kemi një përkushtim edhe në zbatimin e këtyre rekomandimeve të dhëna nga ZKA-ja.

**Hajdar Beqa:** Sa i përket punësimeve, këto informata i kemi shpesh edhe në media e që më vonë na i vërteton edhe ZKA-ja. Por, këtu po shihet që tendenca e rekrutimit ka qenë për të ardhur dikush tjetër, jo ata që e meritojnë. Pyetja ime ishte pse jeni pajtuar pjesërisht me gjetjet? Ndërsa pyetja tjetër ka të bëjë me largimin e gazetarëve, të cilët edhe kanë qenë gazetarë të vijës së parë të fronit, siç është rasti i Milaim Zekës. Një pyetje tjetër nga brenda RTK, ka zëra që stafit po u kërkohet nga Bordi, raporte mujore për Departamentin e Marketingut. Pse po kërkohet raporti në baza selektive dhe nuk kërkohet edhe nga departamentet tjera. Sepse ka dyshime brenda që kjo po bëhet qëllimshëm, në mënyrë që marketingun me qitë krejt jashtë RTK-së.

**Besnik Boletini RTK:** Nuk jemi pajtua për çështjen A1 dhe në aspektin profesional, na flet drejtori që është me ne këtu. Sa i përket çështjes së largimeve, nuk është në kompetencën time me largu dikë. Po nëse dikush nuk vjen në punë atëherë ne duhet me largu drejtorin, sepse nuk mund të vijë në punë për të pirë kafe. Sa i përket marketingut, ne nuk jemi të kënaqur me performancën në marketing, prandaj kërkohet të dhëna dhe detaje me pa ku janë mangësitë, s'ka të bëjë me presion të veçantë, por ku ka mangësi, në cilindo departament, kërkohet sqarime.

**Gazmend Rexhepi RTK:** Pjesa që nuk jemi pajtua, është rivlerësimi i pasurive. RTK-ja ka pasur gjithsej 10 mijë asete. Prej tyre 134 asete kanë pasur vlerën zero, pra është 1% dhe kjo nuk është bazë materiale që mundet me ndikua te baza për kualifikimin e opinionit. Zgjedhjen e metodës së

vlerësimit dhe amortizimit, menaxhmenti ka gjykuar që gjatë këtij viti të mos ketë vlerësim. Por, paraprakisht RTK-ja, ka bërë një proces të rivlerësimit në vitin 2020, me rekomandim të auditorit ligjor dhe ky raport është marrë për bazë nga auditori ligjor. Ndërsa tani gjatë procesit të auditimit, ky raport nuk është konsideruar si relevant për çështjen e vlerësimit të pasurive qarkulluese.

**Shkëlqim Xhema, ZKA:** Ne jemi pajtuar me të gjitha çështjet, edhe me këtë që po e trajtojmë, por nuk jemi pajtuar me opinionin. Ne veprojmë në bazë të standardeve ndërkombëtare të auditimit, e kemi përcaktimin e materialitetit tonë, andaj vlera si e tillë e kalon vlerën e materialitetit, prandaj edhe ka ndikua te opinionin.

**Albulena Mehmeti, RTK:** Ne kemi prit, që performanca e marketingut me qenë më e mirë, gjë që ka sjellë shqetësime të vazhdueshme në mbledhjet e Bordit. Edhe pse e kemi bërë rregulloren dhe kemi shtuar aktivitetet, prapë performanca ka qenë në rënie, krahasuar me vitin paraprak. Prandaj kemi kërkuar detaje që ta identifikojmë problemin. Asnjëherë brenda bordit, nuk është diskutuar, shitja e marketingut të RTK-së. Por, duhet të angazhohemi në maksimum sepse është e domosdoshme që të hyrat e marketingut në RTK të shtohen.

**Albana Bytyqi:** A do të thotë kjo, që ju keni ofruar program për ta shitur marketingun?

**Albulena Mehmeti RTK:** Tani për tani programet janë, por performanca e marketingut nuk është e kënaqshme. Menaxhmenti i RTK-së dërgon raporte mujore për Bordin për performancën e gjitha departamenteve. Por, fokusi i jonë është te Departamenti i Marketingut, por kjo nuk do të thotë që nuk kemi vërejtje edhe për departamentet tjera. Kjo është përmirësim.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Në fakt, performanca e Departamentit të Marketingut, është një prej departamenteve kryesore. Edhe për ne si parlament, që e ndajmë buxhetin, e RTK-së, është me rëndësi, sepse nisë ju e rritni buxhetin përmes të hyrave vetjake, për buxhetin e Kosovës do të ketë kosto më të ulët buxhetore. Por performanca e këtij departamenti lidhet me departamentet tjera, sepse ka të bëjë drejtpërdrejt lidhje me shikueshmërinë. Sepse kemi TV tjera që nuk marrin fare nga buxheti i Kosovës, por ekzistojnë komplet, fal reklamave që e bëjnë. Sa i përket rekomandimeve, ne kemi pa që keni zbatueshmëri. Sa i përket rekomandimit tonë, aty nuk jeni përgjegjës vetëm ju, por janë të ndërlidhura edhe institucionet tjera. Por përkundër zbatimit të rekomandimeve, shohim që kemi gjetje të tjera, do të ishte dashur ta kemi edhe një situatë të mirë edhe aktuale.

**Besnik Boletini RTK:** Pajtohem me konstatimin e juaj kryetare. Andaj ku hasim defekte i ndërmarrim veprimet me i përmirësua. Te çështja e programeve nuk pajtohem, sepse kemi pasur matje nga terreni. RTK-ja qëndron jashtëzakonisht mirë me shikueshmëri. Pajtohem që TV private kanë të hyra, andaj pajtohem që mund të kemi edhe ne, andaj kërkojmë më shumë punë që mi rrit të hyrat dhe kështu edhe investimet.

**Shkumbin Ahmetxhekaj:** Sa i përket konkurseve, personat që kanë aplikua përmes e-mailit kanë emër dhe mbiemër dhe e kanë marrë si të mirëqenë faktin që dokumenti konsiderohet i nënshkruar. Normal, do të doja sikur të mos kishin ndodhur fare gjërat e tilla. Ndërsa rrumbullakimi i pyetjeve,

është një problem te pozita e IT-së. Ku dy e kanë rrumbullakësu përgjigjen, por edhe kanë shkrua shtesë përgjigjen e vet. Andaj komisioni ka vlerësua te marrin 0 pikë sepse kanë shkrua më shumë se që kërkohet. Prandaj, nëse kjo është problematike RTK-ja nuk e ka problem ta ripërsërisë konkursin. Nuk ka favorizime, por është një lëshim i komisionit përkatës. Tani me rregulloren e re do t'i mbajmë përgjegjës të gjitha komisionet për vlerësimet e tyre.

**Hajdar Beqa:** Me gjithë këto, shkeljet procedural drejtor, mund të përfitojë dikush. Sepse në rastet kur ka shkelje dhe përsëritet konkursi, nuk konsiderohet edhe shkelje e madhe. Por, kemi rast sipas auditorit ku e ka rrumbullaku pika, është dashtë mu vlerësua me 10 pikë është vlerësua 0. Po ashtu, rasti tjetër është, ku aplikacioni nuk është në harmoni me datën e konkursit.

**Shkumbin Ahmetxhekaj:** Rasti që po e përmendni, është ripërsëritje e konkursit dhe aplikuesi e ka marrë formularin e aplikimit paraprak si të mirëqenë, andaj edhe është e gjetur.

**Albana Bytyqi:** U diskutua dhe na ka bërë me u shqetësua, ku njëri kandidat për pyetjen e njëjtë është vlerësua me 10 poenë dhe tjetri me 0. Ajo që po me duhet me ditë është çështja A5, për çfarë hapësire reklamuese bëhet fjalë. Pyetja tjetër është se me çfarë baze kërkoni largimin e udhëheqësve të departamenteve, përderisa ju jeni vetëm Bord. Auditori po ashtu, ka gjetur 20 maj euro dënime nga inspektorati për paligjshmëri, a është kjo e vërtetë. Tjetra që kisha dashtë me ditë, a është dikush nga ju i hetuar për krime ekonomike dhe në prokurori?

**Shkumbin Ahmetxhekaj:** Kjo pyetja e fundit, se di pse është aq atraktive, po në secilin komision të Kuvendit na parashtrohet. A jeni nën hetime. Po ku e dimë a jemi nën hetime. Ne nuk jemi ftuar asnjëherë nga askush. Te konkurset e thash, është çështje procedurale që nuk do të duhej të ndodhte. Te çështja A5, kemi një operator ekonomik, pra është një kontratë, ku kemi kërkua shërbime të internetit dhe të telefonisë mobile

**Besnik Boletini RTK:** Sa i përket largimeve nuk e di që kemi largu, po ashtu, po e jepi një sqarim për hetimet.

**Albana Bytyqi:** Ju kryetar i bordit, vetë mënyra se si keni ardhur në bord, ka dyshime se jeni rast për hetim dhe një ditë keni mu ftua.

**Besnik Boletini RTK:** Faleminderit shumë shpresoj. Gjatë evidentimit të parregullsive që kanë ndodh në vitet paraprake. Kemi dërgua rreth 10 dosje në prokurori dhe shpresoj që më thirrën për këto çështje.

**Albulena Mehmeti RTK:** Departamenti i Marketingut funksionon në atë mënyrë, i takojnë bizneset dhe e ofrojnë hapësirën reklamuese që është brenda një programi. Ekziston rregullorja që e sqaron saktë këtë proces.

**Fatime Lumi Qehaja RTK:** Vetëm për sqarim, RTK-ja nuk bënë programe me shit marketing. RTK-ja bënë programe sepse është e obliguar me ligj me ofrua programin për qytetarët e Kosovës,

pastaj është hapësira reklamuese shitet brenda atij programi, por marketingu ndikon nga cilësia e programeve.

**Mirlinda Tishukaj- Sadiku:** E dimë që në të kaluarën nuk ka pasur auditim të RTK-së, nga ZKA-ja. Çka ka ndodh me ato shkeljet që janë adresua në prokurori, a keni marrë ndonjë përgjigje se çka ka ndodh me to. Sepse siç jemi informua nga ZKA-ja, nga një numër i madh i raporteve të dërguara në prokurori nga ZKA-ja, një numër i vogël janë trajtua nga prokuroria deri tani dhe ka vetëm 3 aktakuza të ngritura. Andaj edhe dyshoj që edhe rasti i RTK-së mund të jetë njëra nga ato raporte që ka mbetur ende pa u trajtuar nga ana e prokurorisë. A keni informata çka ka ndodh? Po ashtu, sa i përket rekrutimit, më intereson drejtor a e keni mbajtur përgjegjës atë komision që e ka bërë një vlerësim të tillë, sepse kjo i ka kushtuar buxhetit të RTK, keni 2 raste ku janë dhënë gjopa me nga 1 mijë euro.

Sa i përket marketingut, isha kurioze ti shoh të hyrat nga marketing. Fatkeqësisht në vitin 2023 ka një rënie të marketingut. Unë dua t'ju përgëzoj për Festivalin e këngës, i cili ka qenë jashtëzakonisht i mirë, andaj a do të duhej të ndodhte e kundërta sa i përket të hyrave nga marketing. Po besoi jeni marrë me këtë çështje, sepse unë e kam lexuar edhe raportin e Bordit dhe vërejtjet që i keni dhënë drejtorit të RTK-së, sa i përket mosfunksionimit efikas të Departamentit të marketingut. Kërkoj falje që po dal jashtë raportit, por është për interesin publik, po ashtu, ka qenë ankesë nga Bordi që nuk ka pasur funksionalizim të investimeve të bëra te fact cheking, ku për këtë ka investua OSBE-ja dhe nëse RTK se ka të funksionalizuar, atëherë njëmend në nuk e di ku duhet të besojmë. RTK, është e vërtet që ka ndryshim të madh nga 2021, por do të doja që RTK-në ta shohim sa më lartë si televizion publik dhe na jepni arsye që ta rritim edhe buxhetin.

**Besnik Boletini RTK:** Sa i përket rasteve të prokurorisë, përveç raportit kemi edhe raste të tjera që i kemi dërgua në prokurori, por deri tani nuk kemi informacion për asnjë rast se deri ku kanë shkuar hetimet. Sa i përket gjobave edhe për bordin është shqetësim dhe mendojmë që gjobat duhet me i pagua ata që i shkaktojnë, përndryshe nuk rregullohet kjo çështje. Ka bazë ligjore për këtë dhe me rregulloren e re si Bord do të insistojmë në zbatimin e kësaj, sepse kjo ndikon edhe në rritjen e nivelit të përgjegjësisë. Sa i përket marketingut, tani i kemi edhe kampionatet dhe po presim rritje, përndryshe nëse s'ka të hyra të marketingut, atëherë na mbetet të dalim vet të punojmë, përndryshe s'di tjetër si veprojmë.

**Shkumbin Ahmetxhekaj:** Sa i përket marketingut, vitin e kaluar kur kemi miratuar projeksionin buxhetor, kemi parashikuar të hyra kesh nga marketing në vlerë prej 600 mijë euro dhe ky plan është arritur gjatë vitit 2023. Pra planifikimi ka qenë më i ulët sepse në vitin paraprak e kemi pasur, Kupën e botës dhe ajo zakonisht sjell të hyra. Normal nuk jemi të kënaqur dhe duhet të bëjmë shumë më shumë. Në gjykimin tim si drejtor, do të ishte mire sikur RTK-ja, të mos ketë reklama fare. Sepse në çfarëdo forme, në të cilat hyjmë në marrëveshje kontraktuale me kompani, në njëfarë forme ta zbehin pavarësinë e televizionit publik. Marrim shembull shumica e televizioneve publike në Evropë nuk marrin reklama, por kanë parapagim direkt nga qytetarët. Këtë vit duke pasur

parasysh që e kemi Ligën evropiane dhe festivalin e këngës dhe jam e sigurt që në 6 mujorin e dytë do të kemi të hyra shumë më të mëdha.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** RTK-ja e ka obligim ligjor të bëjë programe edukative dhe informative dhe jo gjithçka duhet të matet me klikime. Por me gjithë këtë treg të ngarkuar medial. Unë për vete në televizionet tona nuk gjej asnjë emision ku diskutohet vetëm për arsimin, shembull dhe as në RTK, ose ka shumë rrallë. Për të biseduar në vazhdimësi për arsimin, shëndetësinë e tema tjera me rëndësi për shoqërinë, ndoshta në fillim edhe mund të mos ketë shikueshmëri. Por, nëse i keni në vazhdimësi dhe dihet që, shembull çdo të mërkurë ka emision për arsimin ku ekspertët nga Kosova diskutojnë për gjendjen në Arsim. Apo çdo të enjte diskutohet për gjendjen në shëndetësi, besoi këto do ta rrisin interesimin dhe shikueshmërinë, por në fakt këto janë gjëra që ne nuk i shohim. Sa i përket reklamave, nuk shoh asgjë të keqe, sepse buxhetin që e merrni nga Qeveria e Kosovës, asnjëherë nuk është i mjaftueshëm. Andaj ju duhet ta shikoni aty ku keni shikueshmëri t'i jepni hapësirat për reklama. Ndoshta duhet ta shikoni mundësinë që Departamentin e Marketingut ta paguani me një bonus, që ta rrisni edhe angazhimin. Sepse si ka mundësi që televizionet private, i kanë të vetat komplet kostot operationale dhe arrijnë të kenë edhe fitim.

**Shkumbin Ahmetxhekaj:** Sa i përket fact cheking, që nga marrja e mandatit e kam pa të nevojshme, që ne duhet ta themelojmë këtë departament dhe kemi filluar diskutimet me organizatat tjera që mund të na ndihmojnë. Fillimisht e kemi zgjedh një staf për ta filluar themelimin e këtij departamenti, të cilin e kemi dërgua në Gjermani për ti marrë modelet. Kemi mendua me realizua një projekt në mes të modelit evropian dhe japonez, të cilët ne kemi bashkëpunim që disa kohë. Pas kthimit të ekipit nga trajnimi, kanë kërkuar të mos angazhohen sepse kane pasur telashe shëndetësore. Pra nuk është i thjeshtë themelimi i një departamenti të tillë. Sepse duhet të kesh profesionist të fushës dhe që i njohin teknikat e hulumtimit. Tani e kemi një ekip tjetër që janë të gatshëm ta marrin këtë përgjegjësi.

**Besnik Boletini RTK:** Sa i përket emisioneve kryetare, po e marr si këshillë dhe keni plotësisht të drejtë. Ne kemi filluar me një emision të tillë një here në javë, ku diskutohet për ambientin dhe pse jo të mos kemi edhe për fushat të tjera me rëndësi, siç janë arsimi dhe shëndetësia. Ndërsa, sa i përket financimit të televizioneve private, nuk e besoi që ato ekzistojnë kryesisht prej marketingut, kanë burime të tjera, por që kjo nuk është temë dhe nuk na takon neve ta diskutojmë.

**Visar Korenica:** Opinioni i kualifikuar i dhënë për RTK, e as për cilëndo organizatë buxhetore nuk është opinion i mirë. Sigurisht që ka një progres nga një opinion i kundërt, siç e kishte RTK-ja në të kaluarën dhe e vlerësojmë. Shembull, kemi ngrit çështjen, ku për mbeturina është paguar 3615 euro për një muaj, e sot paguhet 168 euro. Një dëm ky për të cilin askush nuk ka shkuar në burg, dikush i ka vjedh këto mjete që janë taksa të qytetarëve të Kosovës. Andaj si deputet publikisht kërkojmë që të ketë reflektim edhe nga ana e prokurorisë. Sepse këto gjana po kalojnë si s'ka ndodh asgjë. Pastaj mbi 500 mijë euro, është shfrytëzua kredit kartela e RTK-së, kjo nuk ekziston më se jeni me 300 mijë euro në llogari para të gatshme dhe ky është një përmirësim. Mbi



800 mijë euro janë pagua për shujta dhe orë jashtë orarit në mënyrë të parregullt, prapë dëm nga buxheti i shtetit. Çështja që ka ndikua në opinion dhe nuk jeni pajtua pjesërisht. Pyetja është pse është pjesërisht, a ka ngecje nga ana e Bordit apo ka ngecje nga palët tjera. Sepse nëse këta e kanë kryer pjesën që ju takon, pse duhet të jetë rekomandim për RTK-në.

**Shkëlqim Xhema, ZKA:** Ka mbetur që Qeveria t'i kryej obligimet e veta. Por, arsyeja pse e kemi trajtuar si pjesërisht, është sepse edhe standardet e kërkojnë, se nëse ti e shfrytëzon një objekt i cili sjell përfitime, duhet të kemi pasqyra financiare.

**Visar Korenica:** Për ne është e rëndësishme që Bordi e ka kryer punën e vet. Pyetja për Bordin është. Në vitin 2024, ju përfundon kontrata për qiranë e veturave. Cili është plani i juaj, a do të bëni kontratën e re të qirasë, apo do të planifikoni për blerjen e veturave. Sepse kërkesa te ne ka qenë me i ble, sepse shumica e atyre veturave me qira kanë qenë të papërdorshme dhe ka qenë mbi gjysmë milioni që janë paguar për këtë kontratë.

**Besnik Boletini RTK:** Kjo çështje është analizuar dhe do të jetë në diskutim në mbledhjen e radhës së Bordit. Menaxhmenti i RTK-së, ka bërë një analizë të tregut të mundësive dhe ka ardhur në përfundim, që RTK-ja, aktualisht paguan 8 mijë euro në muaj qira për shfrytëzim të veturave. Andaj jemi në analizim e sipër për të marrë një kredi dhe me i ble këto vetura. Menaxhmenti ka propozuar 22 automjete, jemi duke i analizua dhe si Bord parimisht pajtohemi që RTK-ja duhet me i ble veturat.

**Visar Korenica:** Pyetja tjetër, te kontrata me kompensim, sa është përqindja e tyre në të hyrat totale. A është përqindja më e ulët apo është rrit kjo përqindje?

**Gazmend Rexhepi RTK:** Po i referohem vitit 2023, kontratat me kompensim, krahasua me vitet paraprake, janë në ulje të lartë. Nga të hyrat e përgjithshme, as 20% e të hyrave vetjake, nuk janë me kompensim. Edhe këto që i kemi janë kryesisht për shërbime, siç është interneti.

**Visar Korenica:** Sa është diferenca me vitin paraprak?

**Gazmend Rexhepi RTK:** Vitin paraprak e kanë kalua 500 mijë, apo afër 1 milion, ndërsa tani as 150 mijë nuk janë.

**Visar Korenica:** Sa është impakti, nëse e keni shkëputë këtë mundësi.

**Gazmend Rexhepi RTK:** Nëse i referoheni PF, shihni llogaritë e arkëtueshme në vitin 2023, në krahasim me vitin paraprak, ku kanë qenë 532 mijë euro të pa inkasuara. Të arkëtueshmet e RTK-së janë vetëm të hyrat nga marketingu, sepse nuk kemi të hyra të tjera.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Pyetja është, nëse ju keni vendos të punoni me para të gatshme dhe jo me kontratat e kompensimit. Prej të njëjtëve kontraktues a ka ra sasia e reklamës, nëse ju keni kërkuar kesh dhe jo me kompensim, a ka ndikua kjo në të hyrat e RTK, cili ka qenë efekti në to?

**Gazmend Rexhepi RTK:** Në aspektin financiar shihet që ka pasur impakt negativ, sepse të hyrat e marketingut janë më të vogla. Po pavarësisht kësaj, jemi munduar të kemi qëndrueshmëri financiare.

**Hykmete Bajrami:** Nëse nuk gaboj, në raportin e vitit 2022, problem ka qenë që te kontratat me kompensim, ju nuk i keni qitë vlerë financiare. ZKA-ja, nuk ka kërkuar të hiqni dorë prej kompensimit, por ju të tregoni që vlera e shërbimit që ju e jepni e ka vlerën monetare kaq, po ashtu, edhe ta cekni vlerën e shërbimit që ju e merrni.

**Shkumbin Ahmetxhekaj:** Pikërisht këtë jemi edhe duke e bërë, kur bëjmë thirrjen publike, shërbimeve i vendosim vlerën monetare. Sepse kur s'ka qenë e definuar ka pasur raste kur minutazhi reklamues në RTK është bërë edhe për 50 cent dhe kjo e ka dëmtuar edhe imazhin e RTK-së.

**Visar Korenica:** Te detyrimet kontigjente, nëse ka mundësi, sa janë ulë ato në menaxhimin e parasë së RTK-së?

**Gazmend Rexhepi RTK:** RTK-ja për herë të parë, ka njohur detyrime kontigjente, ku për performancën financiare është mbi 374 mijë euro. Është një proces gjyqësor, i cili ka ndodh në vitin, para vitit 2022, 2021 e tutje. Ende nuk është vendim i fundit, por duke e pa probabilitetin që është në disfavor të RTK-së, ne e kemi njohur si detyrim kontigjent në vlerë të 374 mijë euro. Jemi duke u ballafaqua me disa borxhe të viteve paraprake, pra jemi duke u ballafaqua me disa situata detyrimore të gjykatave, ku përmes përmbaruesve privatë, janë duke i tërhequr nga xhirollogaria e RTK-së. Vlen të theksohet që vetëm në vitin 2024, janë tërheq rreth 200 mijë euro dhe kjo po na pengon në planifikimet tona.

**Besnik Boletini, RTK:** Për ta plotësuar, në këto 2 vitet e fundit nuk kemi krijuar asnjë borxh. Janë kryesisht borxhe të viteve paraprake dhe përkundër kësaj kemi arrit t'i shlyejmë mbi 50% të këtyre borxheve, nga 1.6 milion euro që i kemi gjet kur e kemi marr mandatin.

**Visar Korenica:** Dua t'ju pyes edhe për bufen e Radios. Operatori që ka qenë aty, nuk është më. i keni vendos 2 aparate të kafesë. Si e shihni ju këtë. A ka qenë vendim i drejtë ky. Po ashtu, thuhet që kostoja e kafesë është më e lartë.

**Shkumbin Ahmetxhekaj:** Kompania që ka qenë duke ofruar shërbime në objektin e RTK-së na ka njoftuar, se nga data 15 prill nuk do të jetë aty. Ne kemi pasur thirrjen e ripërsëritur 2 herë dhe nuk ka pas asnjë ofertues. Andaj si zgjidhje të ndërmjetme i kemi vendos aparatet e kafesë. Pra, është një zgjidhje momentale.

**Visar Korenica:** Mendoj se duhet ti rishikoni kriteret dhe të përsëritet thirrja, sepse kjo e lehtëson stafin që të obligohen të dalin jashtë objektit për shërbime të tilla. Një pyetje tjetër jashtë raportit. Drejtoresha e burimeve njerëzore ka dhënë dorëheqje, për shkak të një drejtori. Do të ishte në interes mu njoftua.

**Besnik Boletini, RTK:** Vetëm sa i përket bufes. Kam kërkuar një sqarim ligjor, nëse ne e kemi të drejtën me ja dhënë dikujt me shfrytëzuar për bufe, përderisa s'kemi të drejtë mbi objektin ku operojmë. edhe kjo është një dilemë që ende nuk e dimë si kemi me vepruar tutje.

**Shkumbin Ahmetxhekaj:** Sa i përket objektit të RTK-së. Qysh në vitin 1999, me vendim të UNMIK-ut, në atëkohë është vendosur që të vendosemi aty. Kjo ka vazhduar deri në vitin 2004, kur është themeluar AKP-ja, pastaj kanë filluar edhe kërkesat që me i liruar objektet, për shkak të privatizimit. Ajo që ka ndodhur së fundmi, është se 2 objektet ku operon RTK-ja, kanë hyrë në listën e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe si të tilla nuk mund të ndërrohet destinimi. RTK –ja asnjëherë nuk ka paguar qira.

**Albana Bytyqi:** Kam një koment, në bazë të kritikave që i pate, duket që ta kanë shtua zullumin, kështu që shpejt edhe mund të shkarkojnë. Sepse sot këtu pati kritika më shumë për drejtorin se sa për Bordin.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Pasi që nuk ka pyetje tjera. Falënderojmë përfaqësuesit e RTK-së për pjesëmarrje.

#### 4. Të ndryshme

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Në këtë pikë kemi disa raporte pa përfundim. Kemi mbetur pa kuorum dhe nuk kemi mundësi t'i shqyrtojmë. Për takimin e radhës është propozuar edukimi, andaj në koordinim me koordinatoren e komisionit dhe sigurimin e kuorumit, do të njoftoheni me kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Hykmete Bajrami,

---

Kryetare e Komisionit

